



**MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE
AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)**

RAPORT MONITORIMI PËR ZBATIMIN E PROCESIT BUXHETOR

Periudha e raportimit: Janar – Dhjetor 2016

Në zbatim të Udhëzimit nr. 1 datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016” dhe Udhëzimit Nr. 2/2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” (të ndryshuar), Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) ka vijuar me kryerjen e shpenzimeve buxhetore brenda programit të vetëm buxhetor me emërtesën:

- **“Menaxhimi dhe zhvillimi i administratës publike”** ku përfshihet buxheti i miratuar dhe akorduar për vitin buxhetor 2016, i ndarë sipas artikujve ekonomikë vijues:

Fondi i Pagave:	54,795 mijë lekë (zëri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	10,186 mijë lekë (zëri 601)
Fondi për Shpenzime Operative:	19,613 mijë lekë (zëri 602)
Fondi i Investimeve të brendshme:	103,052.2 mijë lekë (zëri 230) (Financim FZHR) 2,520 mijë lekë (zëri 231) (Financim FZHR) 59,019.450 mijë lekë (zëri 230)
Fondi i Investimeve të huaja:	40,000 mijë lekë (zëri 230) (financim i IBRD) 100,000 mijë lekë (zëri 231) (financim i IBRD)

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (zërat 600+601) janë realizuar në zbatim të strukturës, organikës organizative të miratuar me VKM nr. 654 datë 14.09.2017. Shumat e realizuara për periudhën e raportimit janë përkatësisht 51,954 mijë lekë për artikullin 600 dhe 8,554 mijë lekë për artikullin 601, që përkthehen në 93 % ndaj totalit të buxhetuar. Ky realizim vjen si rezultat i numrit faktit të të punësuarve gjatë periudhës së raportimit si dhe pagesave respektive.

Numri faktik i punonjësve të punësuar deri në fund të muajit Dhjetor 2016 është 90 persona. Brenda këtij numri janë të përfshirë dhe 3 punonjëse me leje lindje të cilat marrin pagesë nga sigurimet shoqërore.

Gjatë kësaj periudhe janë punësuar si personel me kohë të plotë 45 punonjës. Prej këtyre, të larguar nga puna gjatë, kësaj periudhe kanë qenë 20 punonjës.

Fondi për shpenzime në mallra dhe shërbime (zëri 602), është realizuar në vlerën 16,338 mijë lekë ose 83 % ndaj totalit. Arsyeja e këtij realizimi vjen si pasojë e faktit se zhvillimi i procedurave të prokurimit dhe lidhja e kontratave kërkon një kohë të caktuar dhe tashmë që kontratat janë lidhur, pritet dorëzimi i tyre dhe më tej të procesohet me pagesat. Fondi i realizuar, në masën 83% ndaj planit vjetor, përfshin pagesat për procedurat e prokurimit për blerje “Blerje Kancelari dhe letër”, “Materiale pastrimi”, “Kontroll teknik vjetor automjeti 2016”, “Regjistrim numri 5 shifror”, “Blerje kartvizita”, “Siguracion TPL seria 1957683/684”, “Shërbim postar”, “Blerje bojë printeri”, “Dietat brenda vendit”, “Blerje karburant”, “Udhëtim jashtë vendit”, “Shpenzime energjiese elektrike”, “Shërbim roje private”, “Shpërblim i Këshillit Drejtues”, “Shërbim riparim fotokopje”, “Riparim porta hyrëse pranë Zyrës Rajonale Tiranë”, “Shërbim internet Zyra Vendore Kavajë”, “Tarifë regjistrimi në ZVRPP”, etj.

Fondi për Investime të brendshme (zërat 230+231), është i detajuar:

1. Konsulencë për ri-inxhinierimin e shërbimeve publike në shumën 103,052 mijë lekë në zërin 230. Realizimi është në shumën 20,610 mijë lekë ose 20% e vlerës së kontraktuar.
2. Blerje paisje kompjuterike në shumën 2,520 mijë lekë, realizuar në masën 100%.

Këto fonde janë mbartur nga vitit i kaluar, pasi janë akorduar në bazë të Vendimit Nr. 29 datë 29.05.2015 të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve (KZHR). Fondet e papërdorura nga fondi për konsulencë ri-inxhinierimi janë mbartur në vitin 2017, mbështetur në amendimin e kontratës përkatëse.

3. Rikonstrukcioni i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Krujë në shumën 21,893 mijë lekë. Ky fond është realizuar në masën 100%. Vlera e kontraktuar ishte 19,144,370 dhe realizimi i saj në vlerën 18,873,255. Diferenca nga vlera e kontratës është 217,115 lekë. Shumë që i përket fondit rezervë të papërdorur.
4. Mbikqyrje punimesh objekti: Rikonstrukcion i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Krujë në shumën 419,424. Vlera e kontraktuar ishte 54,000 lekë. Kjo kontratë është e realizuar në masën 100%
5. Kolaudim punimesh objekti: Rikonstrukcion i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Krujë në shumën 40,589 lekë. Nuk është realizuar pagesa.
6. Mobilimi i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Krujë në shumën 2,758,373 lekë. Ky fond u dërgua për zhvillim të procedurave të prokurimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme,

por kjo procedurë nuk mundi të përfundojë brenda afatit të përcaktuar të lëvrimit të mallit 31.12.2016.

7. Blerje pajisjesh TIK për Qendrat e Integruara të Shërbimeve Publike Krujë, Gjirokastër, Kukës në shumën 21,673,071.6 lekë. Vlera e realizuar e kontratave ishte në masën 11,625,307 lekë në masën 100%.
8. Rikonstruksioni i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Gjirokastër në shumën 60,666 mijë lekë në total për dy vite buxhetore, i detajuar në shumën 12,000 mijë për vitin 2016. Ky fond nuk është realizuar për shkak të mospërfundimit të procedurës së prokurimit.
9. Mbikqyrje punimesh objekti: Rikonstruksion i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Gjirokastër në shumën 235,080 lekë. Duke qenë se procedura e prokurimit për Rikonstruksionin e Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Gjirokastër nuk ka përfunduar, nuk është proceduar më tej as më procedurën e prokurimit për mbikëqyrje punimesh të rikonstruksionit të kësaj Qendre.

Fondi për Investime të huaja (zërat 230+231), është miratuar në shumën 40,000 mijë lekë në zërin 230 dhe 100,000 mijë lekë në zërin 231 (të ndryshuara me Akt Normativ në fund të vitit). Financimi i huaj është i detajuar sipas regjistrimit të prokurimeve të miratuar nga Banka Botërore. Nga ky fond janë realizuar 985,724 euro ose 130,710 mijë lekë. Në përqindje realizimi i financimit të huaj është në masën 93%.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2016, të parashikuara në PBA 2017-2019, janë si më poshtë:

1. Ngritja dhe menaxhimi i më shumë se 5 qendrave të integruara për ofrimin e shërbimeve administrative (Rikonstruksion i Qendrave të Integruara në më shumë se 5 qytete); Ngritja dhe administrimi i sporteve fizike (FO)
2. Përfundimi i procesit të ri-inxhinierimit të shërbimeve publike. Miratimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe adaptimit të teknologjise.
3. Hartimi i standardeve për ofrimin e shërbimeve publike në sporte, në bazë të modelit të kujdesit për klientin.
4. Matja e performancës së zyrave pritëse
5. Ndërtimi dhe forcimi i kapaciteteve institucionale
6. Përcaktimi dhe zhvillimi i kanaleve të informimit të qytetarëve mbi shërbimet publike
7. Përcaktimi i rregullave për hartimin e modeleve të shërbimeve publike dhe të kodifikimit të tyre
8. Fushatë ndërgjegjësimi për reformën e shërbimeve publike

9. Studimi i fizibilitetit për ndarjen e sporteve nga zyrat e ofrimit të shërbimeve publike në Institucionet Qendrore

Realizimi i këtyre objektivave nënkupton, në mënyrë të drejtpërdrejtë, realizimin e aktiviteteve dhe produkteve të argumentuara si më poshtë.


Realizimi i Produkteve:

Për produktet e paraqitura në PBA 2017-2019, verifikohet një ecure e mirë e realizimit të tyre referuar kontratave respektive.

Produkti	Përshkrimi	% Realizimit
Produkti A:	Lëvrime të shërbimeve në sporte (FO) nga ADISA në shërbim të qytetarit.	100%
Produkti B:	Lëvrime të shërbimeve në sporte të integruara për qytetarët. (Kavaja)	100%
Produkti C:	Thjeshtëzimi i procedurave administrative për përfitimin e shërbimit publik	60%
Produkti D:	Ndryshime ligjore për arritjen e procesit të ri-inxhinierimit	80%
Produkti E:	Standarde të miratuara për ofrimin e shërbimeve publike (Karta e Qytetarit, formularët standard të aplikimit)	95%
Produkti F:	Implementim i sistemit matës së performancës	50%
Produkti G:	Menaxhimi dhe zhvillimi i kapaciteteve institucionale	100%
Produkti H:	Kanale të shumfishta informimi për qytetarët	1000%
Produkti I:	Inventari qendror i procedurave administrative	100%
Produkti J:	Fushatë ndërgjegjësimi	100%
Produkti L:	Studimi i fizibilitetit	100%

Në vijim paraqitja grafike me përqindjen e realizimit të produkteve:

% Realizimit të produkteve të PBA



■ Produkti A: ■ Produkti B: ■ Produkti C: ■ Produkti D:
■ Produkti E: ■ Produkti F: ■ Produkti G: ■ Produkti H:
■ Produkti I: ■ Produkti J: ■ Produkti L:

Më poshtë po ju paraqesim një argumentim të shkurtër të vlerave të realizimit të vendosura nga ana jonë, si më poshtë:

Produktin A: Realizimi është vendosur 100% sepse është marrë nën administrim sporteli i ZVRPP Tiranë, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore. ADISA aktualisht lëvront të gjitha shërbimet e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (51 shërbime nga 51 shërbime në total), dega Tiranë.

Produkti B: Qendra e Integruar e Shërbimeve Publike në qytetin e Kavajës është funksionale qw prej muajit Tetor 2016.

Aktualisht janë mbyllur procedurat e prokurimit, është lidhur kontrata dhe po punohet për rikonstruktionin dhe hapjen e Qendres së Integruar Fier.

Për Qendrën e Integruar të Shërbimeve Publike në qytetin e Krujës është mbyllur procedura e prokurimit dhe wshtw pwrfunduar rikontruksioni i godinws. Nw muajin shkurt 2017 do tw prokurohen mobiljet dhe mendohet tw jetw funksionale si Qendrwr nw muajin Mars 2017.

Për Qendrën e Integruar të Shërbimeve Publike në qytetin e Gjirokastrës është publikuar në faqen e APP procedura e prokurimit për rikonstruktionin e saj dhe pritet përfundimi i saj.

Produkti C: Eshtë në proces zbatimi i kontratës së ri-inxhinierimit nga konsulentët kombëtar.

a) Konsulenca kombëtare:

Nga Deloitte Albania sh.p.k është dorëzuar raporti i parë dhe është likujduar në masën 20% e vlerës së kontratës. Kontrata, e cila është në proces, po ndiqet nga eksperti i jashtëm dhe ADISA.

b) Konsulenca ndërkombëtare:

Kontrata është përfunduar dhe dorëzuar nga konsulenti ndërkombëtar. Gjithashtu është realizuar edhe pagesa e saj.

Produkti D: Ecuria e këtij produkti varet nga kontrata e lidhur me Deloitte Albania. Kompania në fjalë ka punuar dhe ka dorëzuar në ADISA draft raportin për aktet ligjore për lotin e parë. Në fillim të vitit 2017 janë bërë takime mbi komentet e ADSIA. Janë adresuar komentet e ADISA dhe dorëzuar aktet ligjore/nënligjore me ndryshime. është në proces pune dorëzimi i lotit të dytë në përputhje me afatet..

Produkti E: Janë miratuar standardet për: formularët e aplikimit; kartela informative e shërbimeve dhe karta e qytetarit. Gjithashtu është kontraktuar dhe është në proces pune kontrata me objekt “Front Office Custom Care Expertise”. Kjo kontratë është e realizuar në masën 100%. Karta e Qytetarit është shpërndarë në 18 Institucione dhe nuk ka pasur asnjë vrejje apo sugjerim për ndryshim të saj. Formularët e aplikimit janë në proces përditësimi për institucionet në fokus, si dhe është shtuar numri i shërbimeve për të cilët do të përgatiten formularët përkatës.

Produkti F: Ky produkt është i lidhur ngushtësisht me kontratën me objekt “Development of the citizen Feedback Mechanism System (CFM)” për ndërtimin e sistemit për matjen e opinionit të qytetarëve. Kjo kontratë është e realizuar në masën 95%. ADISA është në pritje të përfundimit të saj. Gjithashtu nga ADISA janë përgatitur 671 pyetësor, është realizuar nje fokus group si dhe takime individuale me bankat e nivelit të dytë dhe aktorë të tjerë të interesuar. Në tremujorin e fundit të vitit Sektori i Performancës ka përgatitur raportin mujor të performancës të institucioneve që raportojnë në eRaport.

Produkti G: Janë realizuar trajnime të vazhdueshme për secilin sektor si dhe për punonjësit e Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike në qytetin e Kavajës. Gjithashtu është realizuar një retreat për stafin dhe një udhëtim në Azerbajxhan/Baku. Për aktivitetin e dytë të këtij produkti (Rritja e kapaciteteve në mallra) është përfunduar prokurimi dhe janë marrë në dorëzim mallrat.

Produkti H: Është bërë promovimi nëpërmjet disa kanaleve promovuese: Fushatë sensibilizimi “Java e Inovacionit”, Facebook, web page (100% i përditësuar), TV, etj. Gjithashtu ka filluar funksionimi i Call Center në fillim të muajit tetor dhe është në process fushata promovuese (spotet në TV, Radio, Fb, etj). Gjithashtu janë shpërndarë edhe postera promovues në Institucione publike në Shqipëri.

Produkti I: Nga të dhënat e marra nga Institucionet Qendrore dhe kartelat informative për secilin shërbim është ndërtuar një database nga Sektori i Informacionit, pane ADISA. Masa e realizimit të kësaj database është 100%. Përditësimi i saj me shtimin e shërbimeve të reja është process i vazhdueshëm.

Produkti J: Ka përfunduar procesi i prokurimit për fushatën e ndërgjegjësimit. Është kontraktuar kompania fituese dhe është lidhur kontrata me objekt “Brand Application and Communications”. Fushata filloi me realizimin e spotit promovues të Call Center nq muajin Shtator, për të vijuar më tej me fushatën promovuese për hapjen e Qendrës të Integruar Kavajë në muajin Tetor 2016.

Produkti L: Zbatimi i kontratës së studimit të fizibilitetit nga E&Y ka përfunduar me sukses. Është dorëzuar nga ana e tyre Raporti final i Vlerësimit për studimin e fizibilitetit dhe gjetjet e tij po vihen në zbatim nga ADISA.